

**RAPORT PERIODIK,
MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT
DERI MË DATË 31.12.2020**

I. Fondi Rezervë

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

1. Ligji nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën 1.7 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:
 - a) *Fondi rezervë i Buxhetit prej 1 700 milionë lekësh, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.*
2. Me Aktin Normativ nr. 6 date 21.03.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, Fondi Rezerve ndryshoi në masën 9.2 miliard lekë, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin e tij, si më poshtë:
 - a) *1700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.*
 - b) *6 500 milione leke si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19*
 - c) *1 000 milione leke per emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-covid 19*
3. Me Aktin Normativ nr 15, date 15.04.2020” Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, te ndryshuar, Fondi Rezerve ndryshoi në masën 16.2 miliard leke, ndërkohë që neni 2 i tij përcakton përdorimin e tij si më poshtë:
 - a) *1700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.*
 - b) *13 500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19*
 - c) *1 000 milionë lekë per emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-covid 19*
4. Me Aktin Normativ nr. 28, date 2.07.2020” Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, te ndryshuar, përdorimi i Fondit Rezervë është përcaktuar si më poshtë:
 - a) *2700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.*
 - b) *13 500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19*

Deri në datën 31.12.2020, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet 28 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej rreth 2.68 miliard lekësh, nga 2.7 miliard lekë të planifikuara ose në rreth 99.5% përqind të planit.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë deri më 31.12.2020 (në milionë lekë)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2020	Miratuar me ligj për vitin 2020	Përdorur me VKM deri 31.12.2020	Mbetur pa përdorur me 31.12.2020	Përqindja (Përdorur/Planifikuar)
	2 700	2 687.1	12.9	99.5%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Më konkretisht, nga përdorimi deri më **31.12.2020**, rezulton se:

- Rreth 77.2 milion lekë ose rreth 3% e planit, janë akorduar për shpenzime personeli.
- Rreth 1.28 miliard lekë ose 47.5 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime korente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme);
- Rreth 1.32 miliard lekë ose 49 përqind e planit, janë akorduar për investime.

Grafiku i mëposhtëm paraqet përkatësisht, strukturën e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, deri më datë 31.12.2020:

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, deri me 31.12.2020 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Nga fondet e miratuara sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për VKM-në nr. 258, datë 27.03.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020, për pagesën e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror”, fondi i miratuar prej 98 400 mije lekësh është akorduar për 97 843 000 lekë sipas shkresës përkatëse.

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë)

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në % ndaj totalit
87	Institucione te tjera Qeveritare	2	904 000	33.6%
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6	509 376	19%
06	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2	350 000	13%
16	Ministria e Brendshme	3	221 446	8.2%
56	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1	170 000	6.3%
12	Ministria e Kultures	1	149 000	5.5%
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	3	128 183	4.8%
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	95 200	3%
17	Ministria e Mbrojtjes	3	80 827	3%
15	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	2	39 951	1.5%
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	20 000	0.7%
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1	14 000	0.5%
22	Akademia e Shkencës	1	4 600	0.2%
03	Kryeministria	1	500	0.0%
	TOTALI	28	2 687 083	100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në mënyrë analitike rezultojnë se:

- ✓ 904 milion lekë janë akorduar për “Institucionet e tjera Qeveritare”, sipas VKM-ve si më poshtë:
 - 44 milionë lekë, janë akorduar me VKM nr 181, datë 26.02.2020 për *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të samitit digjital të Ballkanit Perëndimor*”.
 - 860 milion lekë janë akorduar me VKM nr 610, dt 29.07.2020 ,”*Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2020, miratuar per Agjencine Kombetare te Shoqerise se Informacionit*
- ✓ 509.3 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas VKM-ve si më poshtë:
 - 400 milion leke me VKM nr. 205, datë 9.03.2020 “*Për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-2019*”.
 - 30 milion leke sipas VKM nr. 259, datë 27.03.2020 dhe VKM 354, datë 29.04.2020 “*Për dhënien e ndihmës me personel infermier për Republikën e Italisë*”.
 - 46.1 milionë lekë janë akorduar për MSHMS me VKM nr. 240, datë 21.03.2020 “*Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-2019*”.
 - 33.27 milion lekë janë akorduar për MSHMS me VKM nr. 371, datë 6.05.2020 “*Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike*”, të ndryshuar.

- ✓ 350 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me VKM-të si më poshtë:
 - 200 milion lekë për shpronësime nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me shigjeta -rrethrotullimi "Shqiponja".
 - 150 milion lekë me VKM nr 464, datë 10.06.2020 "Për studim projektim Tuneli i Llogarasë".
- ✓ 221.4 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Brendshme me VKM-të si me poshtë:
 - 27 milion lekë janë akorduar për përballimin e shpenzimeve të kontratës me kompaninë "Tilag Group Ltd".
 - 150 milion lekë janë akorduar për investime per MB me VKM nr. 106, dt 5.02.2020.
 - 44.4 milion lekë, janë akorduar për shpenzime për investime me VKM-në nr. 984, datë 3.12.2020 "Për dhënie miratimi për përdorim fondesh e për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020 miratuar për Ministrinë e Brendshme".
- ✓ 170 milion lekë janë akorduar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit për investime me VKM-në nr. 1127, datë 30.12.2020.
- ✓ 149 milion lekë janë akorduar për shpenzime kapitale për Ministrinë e Kulturës me VKM nr.647, dt 30.07.2020.
- ✓ 128.2 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet VKM-ve si më poshtë:
 - 98.4 milion lekë me VKM nr 258, dt 27.03.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020, për pagesën e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror"
 - 26 milion lekë për rimbursimin e gjobave të vëna nga autoritetet të shteteve të huaja për shtetasit shqiptarë me VKM nr. 474, dt 15.06.2020.
 - 3.78 milion lekë me VKM-në nr. 1019, datë 16.12.2020 "Për ekzekutimin e VGJEDNJ, për çështjen 'Kasmi kundër Shqipërisë'"
- ✓ 95.2 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me VKM –në nr. 378, dt 8.05.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Turizmit e Mjedisit, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të personave që riatdhesohen".
- ✓ 80.8 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Mbrojtjes konkretisht me VKM nr. 204, datë 9.03.2020 "Për marrjen e masave për ngritjen e infrastruktures për shërbimin e karantinës" për 24.8 milion lekë dhe 2.5 milion është akorduar një shtesë fondi me VKM nr 611, dt 29.07.2020, si edhe 50.3 milion lekë janë akorduar me VKM nr. 911, datë 4.11.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, për bashkitë Patos dhe Roskovec, për dëmshpërblimet e familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga lëkundjet e tokës".

- ✓ 39.9 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme”, nëpërmjet dy Vendimeve nga të cilat 8.7 milion leke “Per dhenie ndihme financiare nga KMI RSH per mbeshtetjen e funksionimit të KK ne Serbi dhe te zyrave te tij ne Presheve dhe Medvegje dhe KK te Shqiptareve ne Mal te zi dhe zyres koordinuese te tij ne Plave”, dhe 31.2 milion lekë “Per dhenie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së SHqipërisë per qeverine e Republikes se Kroacise, për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i dt 29.12.2020”.
- ✓ 20 milion lekë janë akorduar fond shtesë për investime Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me VKM nr. 437, dt 3.06.2020.
- ✓ 14 milion lekë janë akorduar me VKM-në nr. 890, datë 21.10.2020 “Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2020, miratuar per Gjykatën e Lartë”.
- ✓ 4.6 milion lekë janë akorduar me VKM nr. 838, datë 28.10.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar per Akademinë e Shkencave”.
- ✓ 500 mijë lekë janë akorduar me VKM nr. 652, datë 17.08.2020 “Për dhënie ndihme financiare familjes së viktimës Samuel Nik Ndoj”.

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 30.12.2020, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, rezulton të jetë vetëm 12.9 milionë lekë.

c) **Deri më datë 30.12.2020, fondi prej 13.5 miliard lekë, i parashikuar** si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19, është përdorur me VKM-të, si më poshtë:

- ✓ 6.416 miliard lekë me VKM nr.254 date 27.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”, të ndryshuar.
- ✓ 7.040 miliard lekë janë akorduar me VKM nr.305 datë 16.04.2020 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktuale dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19.

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 30 Dhjetor 2020, gjendja e papërdorur e Fondit Kontigjencë per paketën sociale anti-Covid 19, rezulton të jetë 44 milionë lekë.